

Njoftim për Shtyp Datë 23 Prill 2025

Datë: 23.04.2025



Sot, më datë 23.04.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli zhvilloi seancën dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. [...] me funksion gjyqtar në Gjykatën [...] dhe në përfundim të saj vendosi pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke caktuar masën disiplinore "Vërejtje publike".

Në vijim, Këshilli vendosi për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 2/2025, të filluar ndaj magjistrates znj. [...], me funksion gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm [...].

Këshilli miratoi vendimet për komandimin e z. Renis Sheshi dhe znj. Valjona Haxhiraj si ndihmësmagjistratë, në Gjykatën e Lartë.

Më tej, Këshilli vendosi miratimin e "Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024".

Në përfundim, Këshilli miratoi vendimin "Mbi përcaktimin e numrin të përgjithshëm të Magjistratëve (Gjyqtarë), në Republikën e Shqipërisë".